



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr.
Nr. Dok. 201600390/4

Prot.

Tiranë ____/____/2016

Lënda : *Rekomandojmë fillimin e procedimit penal ndaj shtetasit Xh. K. për kryerjen e veprës penale të shpërdorimit të detyrës në bazë të nenit 248 të K.Penal.*

Drejtuar : Z. BESNIK CANI
Drejtues i Prokurorisë,
Rrethit Gjyqësor Elbasan

ELBASAN

Për dijeni : Z. ADRIATIK LLALLA
Prokuror i Përgjithshëm

TIRANË

I nderuar Zoti Cani,

Nga shqyrtimi i ankesës së shtetasit E. Rr. drejtuar institucionit Avokatit të Popullit, rezultoi se ai me datën 11.10.2010, ai i është drejtuar me kërkesë padi civile Gjykatës Rrethit Gjyqësor Elbasan kundra të paditurit F. D. me objekt, lirim dhe dorëzim i pasurisë dhe për shpërbllim dëmi nga përdorimi i një sendi.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin e saj Nr.1761 datë 09.09.2011 me gjyqtar Xh. K. ka vendosur:

Pranimin e kërkesë padisë.

Detyrimin e të paditurit F. D. që t'i lirojë e dorëzojë paditësit E. Rr. një ndërtesë dykatshe ku kati i parë ka një sipërfaqe prej 472.5 m2 dhe kati i dytë ka sipërfaqe 485m2 të ndodhur në lagjen "28 Nëntori" të qytetit Elbasan duke përcaktuar vendndodhja me kufizimet e ndërtesës sipas hartës treguese të regjistrimit që është bashkëngjitur certifikatës për vërtetim pronësie të lëshuar nga ZRPP Elbasan.

Detyrimin e të paditurit F. D. që t'i paguaj paditësit E. Rr. një dëmshpërbllim për përdorimin e ndërtesës dykatshe në shumën prej 1.000.000.lekësh.

Ankuesi E. Rr. nga ana e tij vazhdimisht ka kërkuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan që të paiset me një vendim gjyqësor të arsyetuar, por atij i është dhënë vetëm një shkurtim vendimi gjyqësor. Për këtë problem ankuesi i është drejtuar me shkrim Kryetarit Gjykatës Rrethit Gjyqësor Elbasan, Ministrit të Drejtësisë, dhe KLD-së etj dhe ky problem deri tani nuk ka gjetur zgjidhje.

Në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ai i është drejtuar me kërkesë për gjykim Gjykatës Kushtetuese të RSH, e cila me vendimin e saj me Nr.5 datë 23.02.2016 ka vendosur si vijon :

Pranimin e kërkesës.

Konstatimin e cënimit të së drejtës së aksesit në gjykatë si pasojë e mosarsyetimit të vendimit Nr.1761 datë 09.09.2011 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Nga verifikimi ynë rezultoi se me vendimin Nr.306 datë 08.03.2013 të KLD-së, gjyqtari Xh. K. është shkarkuar nga detyra e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Me këtë rast ai ka dorëzuar në Sekretarinë Gjyqësore 709 dosje të ndryshme të gjykuara dhe pa vendime gjyqësore të arsyetuara.

Kështu provohet se ky gjyqtar në kundërshtim me ligjin dhe rregullat roceduriale të gjykimit nuk ka arsyetuar vendimet për 102 dosje me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, 126 dosje administrativo penale për marrjen e masave sigurimi dhe 481 dosje civile nga viti 2007 e deri në vitin 2013.

Në veprimet e tij gjyqtari Xh. K. në rastin konkret ne konstatojmë se ekzistojnë elementet e veprës penale të shpëdrimit të detyrës parashikuar nga neni 248 i K.Penal dhe ndaj tij ka vend për fillimin e procedimit penal.

Në nenin 248 të K.Penal thuhet se: "Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a të mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbyllje të rregull të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jo materiale të padrejta, a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridik, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtat vjet ose me gjobë nga njëmijë deri në një milion lekë.

Rezulton se shtetasi Xh. K. ka punuar si gjyqtar nga viti 1995 e deri me datën 08.03.2013, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe për këtë punë të kryer ai është paguar rregullisht sipas legjislacionit në fuqi.

Në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të drejtave të njeriut, nga administrata publike", dhe në bazë të kërkesave të nenit 21/ç të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet se: "Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit i rekomandon Prokurorisë Rrethit Gjyqësor përkatës të fillojë hetimet në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një vepre penale.

Për sa më sipër, ju

REKOMANDOJMË :

1.Fillimin e procedimit penal ndaj shtetasit Xh. K. për kryerjen e veprës penale të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i K.Penal.

2.Mbi analizën dhe pranimin e këtij rekomandimi dhe masat e marra nga ana juaj, lutemi na njoftoni me shkrim brenda 30 ditëve.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI